



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT**

Komisioni i Infrastrukturës, Shërbimeve, Transportit ,Administrimit të Territorit

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Mbi miratimin e shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurisë të paluajtëshme pronë private, që preken nga realizimi i projekt “Ndërtimi i rrugës bilçe –Drobonik”, Bashkia Berat.”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr. 8561, datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, VKM-së nr. 127 datë 23.03.2000 për “Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Bashkia Berat ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik për pasuritë pronë private, për gjithsej 48 pronarë, të pronës të llojit “kullota” “toke are”, “toke truall” “ullishte” dhe “ndertese” të ndodhura në Zonën Kadastrale 1217, për të cilat kerkohet miratimi juaj lidhur me vijimin e procedurave të shpronësimit për projektin “NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK, BASHKIA BERAT”

Projekti më sipër dhe miratimi në parim të procedurave të shpronësimit, është miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.27 datë 17.04.2024.

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni për procedurat e shpronësimit për interes publik, bazuar në dokumentacionin përkatës të projektit "NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK, BASHKIA BERAT" dhe këqyrjen në vend, thekson se prona private që preken nga realizimi i këtij projekti shtrihen në zonën kadastrale 1217.

Pasuria që preken nga investimi, me pronarë privatë, janë bashkëngjitur tabelës ku çmimet e shpronësimit përlllogariten dhe janë përcjellë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Situata financiare :

Vlera totale e shpronësimit është: **16,181,340** lekë për pronat që shpronësohen për 48 pronare sipas tabelës bashkëngjitur.

Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti Afatmesëm 2026- 2028 i Bashkisë Berat.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Komisioni i Shpronësimeve pranë Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Inspektoriati i Monitorimit të Territorit.

Impakti social / grupet që preken:

Grupet që preken janë pronarët të cilët do të shpronësohen për pjesët e pronës që do të preken nga projekti, bazuar në çmimet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi, marrë me shkresë zyrtare nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Komisioni i Infrastrukturës, Shërbimeve, Transportit ,Administrimit të Territorit, i mbledhur në datën 17/10/2025, shqyrtoi projekt vendimin "MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: "NDËRTIMI I
RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK ,BASHKIA BERAT

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Të miratojë procedurën për shpronësim për interes publik për realizimin e projektit " Ndërtimi i Rrugës së Re Bilçë-Drobonik", të pasurisë private që preket nga ky projekt me vlerën **16,181,340** lekë sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Shpronësimi do të financohet me fondet e Buxhetit të Bashkisë Berat.gjatë viteve 2026,2027,2028

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Albjon Sula

Llazarion Teneqexhiu

Fadil Kallanxhiu

Muharrem Hoxha

Oltion Merdari

Datë 17 /10/2025